

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap-Kz- 89/2011

Data: 18 maj 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit Francesco Florit si Kryetar, gjyqtarëve Martti Harsia, Salih Toplica, Nazmije Ibrahimimi dhe Marije Ademi si anëtarë të kolegjit, në praninë e Adnan Isufi Zyrtar Ligjor i EULEX-it, i cili vepron në cilësinë e procesmbajtësit, në lëndën penale P.nr 01/2010 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë kundër të pandehurit:

A [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED] në paraburgim prej 16 dhjetor 2008 deri më 8 shtator 2010, i akuzuar sipas Aktakuzës PP nr. 128/08 të ushtruar më 15 korrik 2009 nga prokurori publik, e miratuar pjesërisht nga pala e dëmtuar A [REDACTED] F [REDACTED] si paditës subsidiar sipas tërheqjes së akuzës për Vrasje nga prokurori publik, për veprat penale të Vrasje në shkelje të Nenit 146 dhe Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit Neni 328 Paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës (tash e tutje "KPK"),

I shpallur fajtor me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica P nr. 01/2010, të datës 14 tetor 2010 për Vrasje të kryer në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme sikurse është përcaktuar me Nenin 146 në lidhje me Nenin 8 par 4, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit Neni 328 Paragrafi 2 të KPK dhe i dënuar me 2 vjet burgim.

Duke vepruar sipas ankesave të ushtruara nga avokati mbrojtës F [REDACTED] B [REDACTED] përfaqësues i palëve të dëmtuara dhe nga avokati mbrojtës M [REDACTED] H [REDACTED] emër të të pandehurit, kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë P nr. 01/2010, të datës 14 tetor 2010; duke pasur parasysh përgjigjen në ankesën e ushtruar nga avokati mbrojtës M [REDACTED] H [REDACTED] si edhe mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) për ankesat e ushtruara më 23 mars 2011,

Pas mbajtjes së seancë së hapur më 18 maj 2012, në praninë e palëve dhe pas mbajtjes së seancës së këshillimit dhe votimit të njëjtën ditë, në pajtueshmëri me Nenet 420, 424 dhe 426 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tutje "KPPK") lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara dhe e të pandehurit A [REDACTED] P [REDACTED] kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 01/2010, të datës 14 tetor 2010, refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 01/2010, të datës 14 tetor 2010, vërtetohet.

Shpenzimet e procedurës penale në shkallën e dytë do të kryhen nga të ardhurat buxhetore në pajtueshmëri me Nenet 99, 100 dhe 103 të KPPK.

ARSYETIMI

I. Historia e procedurës

Më 16 dhjetor 2008 rreth orës 14.00 në fshatin Rahove, komuna e Mitrovicës, në vendin e quajtur "Quka e Lisices" pas një mosmarrëveshje, i pandehuri A. P. ka shtënë me pushkën e tij automatike në P. F., plagët e shkaktuara nga plumbat ishin vdekjeprurës për viktimën.

Më 19 dhjetor 2008 Prokurori Publik i Qarkut, nisi hetimet kundër të pandehurit A. P. dhe më 15 korrik 2009 Prokurori Publik ngriti Aktakuzën PP nr. 128/08 në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kundër të pandehurit A. P. për kryerjen e veprës penale të Vrasje në shkelje të Nenit 146 dhe veprën penale Mbjajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sikurse është përcaktuara me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK.

Më 12 janar 2010, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë konfirmoi aktakuzën. Pas vendimit të datës 2 gusht 2010 të Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it për caktimin e lëndës gjyqtarëve të EULEX-it, procedura e gjykimit filloi më 12 tetor 2010 në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

Më 14 tetor 2010, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë me aktgjykimin P nr. 01/2010 shpalli të pandehurin A. P. fajtor për veprën penale Vrasje të kryer në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme në shkelje të Nenit 146 në lidhje me Nenin 8 par 4, dhe veprën penale Mbjajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sikurse është përcaktuar me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK. Dënimi në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme është hequr për shkak të traumës së rëndë të frikës nga sulmi i tani të ndjerit shkaktuar të pandehurit; për veprën penale Mbjajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sikurse është përcaktuar me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK, gjykata ndaj të akuzuarit shqiptoi dënimin me dy vjet burgim.

Aktgjykimi i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë është kundërshtuar nga pala e dëmtuar respektivisht paditësi subsidiar përmes përfaqësuesit ligjor Av. F. B. dhe të pandehurit A. P. përmes avokatit të tij mbrojtës M. H.

Zyra e Prokurorit të Shtetit (ZPShK) ka paraqitur mendimin PPA 89/11 përmes të cilit kërkon të refuzohen të dyja ankesat si të pabazuara dhe të vërtetohet aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 01/2010, të datës 14 tetor 2010.

II. Ankesa e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara.

Në ankesë, pala e dëmtuara ka denoncuar (i) shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe (iii) shkelje të ligjit të penal në lidhje me vendimin për sanksionin penal.

Në ankesën e vet, pala e dëmtuar ka theksuar shkeljen e dispozitave esenciale të procedurës penale të përcaktuara me nenin 403, par. 1, pikën 8 dhe 12 të KPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me përmbajtjen dhe arsyetimin e aktgjykimit; përveç kësaj, pohohet se në arsyetim nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare përderisa arsyet e prezantuara janë të paqarta; më tutje, sipas ankesës, lidhur me faktet vendimtare ekzistojnë kontradikta të konsiderueshme në mes asaj çfarë është prezantuar në arsyetimin e aktgjykimit dhe në përmbajtjen e shkresave të lëndës apo në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Për më tepër, dispozitivi i aktgjykimit nuk ofron përshkrimin e trajektorës së plumbave nëpër vrimën hyrëse dhe dalëse si dhe shkakun e katër plagëve të shkaktuara. Për më tepër, nuk ka asnjë argument specifik që justifikon arsyen pse veprimi i të akuzuarit është cilësuar si mbrojtje e nevojshme. Pala e dëmtuar insiston se përshkrimi i dhënë faktik në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim jo vetëm me përshkrimin faktik të aktakuzës së prokurorit dhe të aktakuzës subsidiare (pasi që pala e dëmtuar nuk e kishte ndërruar aktakuzën) por edhe me përmbajtjen e provave të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Pala ankuese më tej pohon se është shkelur e drejta e tij për mbrojtje efektive. Avokati mbrojtës deklaroi se gjykata duhet patjetër të sigurojë që palës t'i jepet mundësia e caktimit të avokatit mbrojtës i cili mund ta përfaqësojë klientin me shkathtësi dhe me ekspertizë që plotëson standardin objektiv të ndihmës së arsyeshme efektive të avokatit mbrojtës. Është thënë se fakti që A. F. është klerik nuk mund të jetë arsye e mjaftueshme për t'i refuzuar mundësinë e caktimit të një avokati mbrojtës profesional me qëllim të garantimit të ndihmës efektive juridike e cila është e nevojshme gjatë procedurës penale. Për këtë arsye, argumentohet se gjykata e shkallës së parë është dashur ta shtyjë shqyrtimin gjyqësor duke i dhënë palës së dëmtuar afat kohor prej tetë ditësh për të caktuar një avokat.

Më tutje, në ankesë thuhet se gjykata gabimisht iu kishte referuar lokacionit të incidentit të ashtuquajtur "fushat e Lisices" se i njëjti i takon fshatit Rahovë duke pasur parasysh se librat e kadastrës e konfirmojnë faktin se fushat e Lisicës i takojnë fshatit Lisicë e jo fshatit Rahovë.

Në fund, ankesa e palës së dëmtuar po ashtu pohon se ka pasur edhe disa shkelje të tjera të procedurës që lidhen me cilësimin gjoja të pavend të veprës penale, të dashjes dhe të motiveve të të pandehurit si dhe moskryerjen e ekspertizës së ADN-së nga ana e gjykatës e cila do ta kishte vërtetuar nëse gjaku i të akuzuarit do të mund të identifikohet në tehun e kmesës apo jo.

III. Ankesa e avokatit mbrojtës M. H. e ushtruar në emër të të pandehurit

M. H. - avokati i të pandehurit, thekson shkeljen e dispozitave të kodit penal të cilat kanë të bëjnë me vendimin mbi dënimin duke pretenduar se i pandehuri nuk ka tejkalar kufijtë e mbrojtjes së domosdoshme por ka vepruar thjesht duke mbrojtur veten në mënyrë të domosdoshme kur ka kryer vrasjen me qëllim të shmangies së sulmit të kundërligjshëm, të vërtetë dhe të pashmangshëm të shkaktuar nga tash i ndjeri. Për më tepër, mbrojtja insiston se kohëzgjatja e sanksionit penal të shqiptuar ndaj të akuzuarit për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në

shfrytëzim të paautorizuar të armëve siç përcaktohet me nenin 328, par. 2 të KPK-së, ka qenë vërtet shumë e ashpër.

IV. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Pas rishikimit të të gjitha shkresave të lëndës, pas studimit të aktgjykimit të ankimuar sipas dispozitave të nenit 415 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të argumenteve të përmendura në ankesa, Gjykata konstaton si më poshtë:

- a. Ankesat janë të pranueshme pasi që të njëjtat janë paraqitur pranë gjykatës kompetente në bazë të nenit 398, par. 1 dhe brenda afatit ligjor sipas nenit 407 të KPPK-së.
- b. Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit pas seancës dëgjimore të mbajtur më 18 maj 2012, siç përcaktohet me nenet 413, 411 dhe 420 të KPPK-së.
- c. Ankesat e përfaqësuesve të palëve të dëmtuara dhe të pandehurit A. P. janë të pabaza.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave ligjore të procedurës penale të përcaktuar me nenin 403, par. 1, pikën 8 dhe 12 të KPPK-së, të përmendura në ankesë.

Vërtet, gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar, ka paraqitur fakte të ciat janë konstatuar në mënyrë të saktë dhe ka dhënë arsye bindëse për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë lëndë. Për këtë arsye, nuk ka kundërshti në dispozitivin e aktgjykimit, as ndonjë kundërshti tjetër në mes të dispozitivit dhe arsyetimit.

Lidhur me këtë pikë, Gjykata Supreme thekson se, në rastet kur ankesa denoncon kundërshtitë e pretenduara të aktgjykimit apo të dispozitivit të tij, nuk është e mjaftueshme vetëm përsëritja e tekstit në formë të formulës mekanike nën numrin rendor 12 të paragrafit 1 të nenit 403 të KPPK-së. Avokati mbrojtës nuk duhet vetëm të tregojë thjesht se ekziston kundërshtia, për shembull në mes të dispozitivit dhe aktgjykimit apo në mes të arsyetimit dhe fakteve të konstatuara gjatë zhvillimit të gjykimit, por ai apo ajo avokate duhet po ashtu të bëjë përpjekje që të sqarojë se çfarë përbën shkelja e pohuar ose pse ekziston një shkelje e këtillë apo pse nuk ka përputhje në mes të fakteve dhe përshkrimit të tyre në vendim. Vetëm deklarimi i thjeshtë se ka kundërshti nuk përbën arsye të mjaftueshme për ankesë dhe nuk i ndihmon gjykatës që të kuptojë argumentin e avokatit mbrojtës.

Dispozitivi iu referohet në mënyrë të duhur të gjitha fakteve vendimtare, përkatësisht numrit të të shtënave, përshkrimit të armës së përdorur nga ana e të pandehurit dhe mënyrës në të cilën është kryer krimi. Në arsyetim, gjykata ka paraqitur arsyet për secilën pikë të aktgjykimit veç e veç. Gjykata Supreme e Kosovës është e kënaqur që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe shteruese ka theksuar faktet që i ka konsideruar të

vërtuara ose të pavërtetuara e gjithashtu edhe arsyet për këtë, dhe në veçanti ka treguar provat në të cilat është mbështetur gjykata kur e ka lëshuar aktgjykimin. Pretendimet që kanë të bëjnë me mungesën e përshkrimit të trajektores së hyrjes dhe daljes së plumbit sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme Kosovës është leximi i pjesshëm i dispozitivit. Në të vërtetë, dispozitivi dhe arsyetimi janë pjesë të koordinuara dhe të pandashme të aktgjykimit. Dispozitivi duhet të përmbaj një numër të mjaftueshëm të dejave, me qëllim që të akuzuarit t'ia lejoj mbrojtjen e duhur. Çdo shtesë që është e tepërt në këtë qëllim duhet të shmanget, sepse do të mund të rrezikoj të shkaktoj konfuzion në vend të qartësisë. Duke e marr parasysh këtë, përshkrimi i trajektores së plumbit është e qartë që nuk është e nevojshme në dispozitiv. Argumenti i avokat F. B. është asgjë tjetër pos pretekstit dhe spekulimit, sepse përshkrimi i trajektores nuk është në asnjë mënyrë i nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e të akuzuarit dhe është befasuese që një argument i tillë vjen nga përfaqësuesi i paditësit subsidiar.

Si i tillë aktgjykimi duhet të lexohet në kontekstin e tij të plotë. Pjesa e arsyetimit të aktgjykimit përmban të gjitha detajet dhe në mënyrë të mjaftueshme ofron shpjegim të gjëndjes faktike bazuar në fakte të cilat në mënyrë të duhur janë marr, administruar dhe vlerësuar nga gjykata. Prandaj pretendimi i avokatit mbrojtës lidhur me papajtueshmërinë e aktgjykimit është i pabazuar.

Sa i përket kufizimit të pretenduar të së drejtës për asistencë efektive ligjore për palën e dëmtuar, Gjykata Supreme vëren që gjykata nuk ka pasur obligim që të caktoj avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare *ex officio* për palën e dëmtuar ose që nuk ka pasur detyrë të shtyjë seancën me qëllim që ti lejoj palës së dëmtuar të caktoj një.

Rrethanat specifike të nevojshme për emërimin e avokatit mbrojtës për palën e dëmtuar (neni 82 i KPPK-së) në mënyrë të qartë nuk janë të pranishme në lëndën në fjalë: pala e dëmtuar nuk është veçanërisht e cënueshme ose në nevojë substanciale të ndihmës së përfaqësuesit të autorizuar. Krejtësisht e kundërta, pala e dëmtuar është person i edukuar dhe i arsimuar.

Nuk ka prova që tregojnë se pala e dëmtuar në çfarëdo mënyre ka qenë e kufizuar që të angazhoj avokatin mbrojtës sipas dëshirës së tij nëse do të dëshironte ta bëjë këtë në cilëndo fazë të gjykimit. Por, pala e dëmtuar nuk mund të presë që gjykimi të shtyhet me qëllim që ti jepet atij mundësia për të emëruar një.

Prandaj, asnjë shkelje të drejtave të garantuara të mbrojtjes për palën e dëmtuar sipas ligjit të aplikueshëm nuk mund të hasen në këtë lëndë.

Sa i përket vendit të incidentit, pretendimi i avokatit mbrojtës është i parëndësishëm. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton që për qëllim të kësaj lënde, komuna të cilës "fusha e Lisicës" i takon, është e parëndësishme. Në të vërtetë nuk ka asnjë dyshim dhe/ose ndonjë paqartësi se ku ka ndodhur vepra penale. Faktikisht, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të saktë ka përmendur praninë e emrave të ndryshëm për të njëjtën zonë, duke mos lënë asnjë dyshim që ishte e vetëdijshme të emrave të ndryshëm të mundshëm të vendit. Veç kësaj, shkresat e lëndës përmbajnë fotografi që paraqesin qartë vendin e krimit; numrat origjinal të vendosur mbi secilën provë të gjetur në vendin e krimit, e bëjnë kuptimin e fotografisë jashtëzakonisht të lehtë. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjen argumentin jo që e vlen dhe pa merita. Pretendimi që krimi ka ndodhur diku tjetër dhe që trupi i viktimës pastaj është transportuar në vendin e ngjarjes është thjeshtë një supozim.

Të dyja palët (i pandehuri dhe pala e dëmtuar) në ankesat e tyre përkatëse theksojnë që cilësimi i veprës penale ishte i gabuar. Pala e dëmtuar pretendon që vrasja do të duhej të kualifikohej si vrasje ndërsa i pandehuri thekson që ka qenë akt i mbrojtjes së nevojshme. Për arsye të lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të duhur e ka kualifikuar veprën si Vrasje e kryer duke tejkualuar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme në shkellje të nenit 146 në lidhje me nenin 8, paragrafin 4 të KPK-së.

Në fund të shqyrtimit gjyqësorë kolegji ka përfunduar që pas një debati verbal, tani i vrari e ka qëlluar të akuzuarin nga prapa me drapër duke ia shkaktuar të pandehurit plagë të hapur në nofullën e majtë dhe kur viktima ka ngritur duart e tij për të qëlluar përsëri, i pandehuri ka filluar të shtijë në R. [REDAKTUAR] F. [REDAKTUAR] me qëllim të parandalimit të këtij të fundit për ta përfunduar sulmin e tij. Ky rekonstruktiv i fakteve bazohet në shpjegimin e ngjarjeve që i pandehuri i njëjtë i ka dhënë, pasi që asnjë person tjetër nuk ka qenë i pranishëm kur ka ndodhur ngjarja.

Gjykata e shkallës së parë ka përfunduar që versioni i të akuzuarit ishte më i besueshmi dhe që ishte vërtetuar me prova objektive. Në të vërtetë, eksperti në cilësinë e dëshmitarit Dr. E. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] tregoi që ai i ka ofruar trajtim mjekësorë të akuzuarit më 16 dhjetor 2006 dhe ka konfirmuar që plaga tek i pandehuri ishte shkaktuar nga një objekt i mprehtë në anën e majtë të nofullës. Përfundimi i trupit gjykues ishte që objekti i mprehtë që është përdorur në veprim dhe i cili i ka shkaktuar plagë të pandehurit ishin gërshërë të gjetura pjesërisht nën trupin e R. [REDAKTUAR] F. [REDAKTUAR] ende të mbajtura me dorën e tij të djathtë, siç është fotografuar në vendin e ngjarjes.

Ky përfundim nuk është vetëm logjik dhe i besueshëm (asnjë mjet tjetër i mprehtë nuk është gjetur në vend të ngjarjes; prania e plagës së freskët është vërtetuar nga mjeku i cili ka bërë qepjen e plagës) por gjithashtu është vërtetuar me element tjetër faktik i cili mund të vërehet nga raporti i autopsisë dhe që në mënyrë bindëse është shpjeguar në vendimin e shkallës së parë (faqe 12, rreshti i 7 dhe ato vijues).

Siç është treguar në fotot e trupit të pajetë të R. [REDAKTUAR] F. [REDAKTUAR] vrimat e hyrjes dhe daljes së plumbave në krahun e sipërm të viktimës tregojnë që trajektorja e të shtënës ishte nga ana e prapme e krahut drejt pjesës së përparme dhe nga lart poshtë.

Me qitësin e vendosur përpara viktimës (vrimat e hyrjes së të shtënave në këmbë tregojnë këtë), shpjegimi i vetëm i drejtimit të trajektores së plumbave të cilët e kanë qëlluar krahun është të konsiderohet që të dy krahët ishin të ngritur lart mbi supet dhe parakrahët ishin edhe më lart, mbi kokë, duke synuar të mbajnë gërshërët lart vetëm një pjesë të sekondës para se e shtëna e dytë do të vinte nga R. [REDAKTUAR] F. [REDAKTUAR]

Pas përshkrimit të ngjarjeve, është lehtë të kuptohet se, siç komenton edhe avokati F. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR] gjatë shqyrtimit, i tërë veprimi nuk ishte i menjëhershëm, por ky veprim mori disa sekonda për t'u zhvilluar. Sa? Natyrisht se askush nuk e di, por mjaft sekonda që A. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] të kthehet kah agresori, pas goditjes së parë, ta pyesë atë me befasi pse ai po e godiste atë, dhe ta përgatisë armën dhe ta drejtojë atë në cak. Preciziteti me të cilin u qëlluan caqet (dora, nga vinte kërcënimi i menjëhershëm, ishte caku i menjëhershëm; këmbët me gjasë ishin qëlluar një pas një) njëkohësisht tregon se A. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] thjesht donte ta mbronte veten (përndryshe, do të qëllonte në pjesët qendrore të trupit) e jo ta vriste. Prandaj reagimi i tij ishte thjesht përgjigje ndaj një kërcënimi të pashmangshëm, e jo tentim për të marrë hak për dhembjet që sapo i kishte përjetuar.

I pandehuri vepronte në mbrojtje, por duke i tejkaluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme që do t'i mjaftonte atij të ikë nga agresori. Nëse i pandehuri do t'i kishte kufizuar të shtënat në dy të parat, kjo do të mjaftonte për ta ndaluar sulmin dhe për t'u larguar i sigurt nga ai vend. Duke shtë në katër herë, i pandehuri e kaloi pragun e arsyetueshëm të reagimit të tij dhe tejkaloi mbrojtjen e nevojshme.

Duke u bazuar në atë çka u përmend më lart, Gjykata Supreme e Kosovës është e kënaqur me cilësimin e gjykatës së shkallës së parë dhe prandaj gjen se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë nuk bëri gabim në ligj. Më saktësisht, zbatimi i paragrafit të fundit të nenit 8 të KPK-së ndaj veprimit të A P duhet të jetë i drejtë. I pandehuri ka kryer vetëmbrojtje të tepruar ekskluzivisht për vendosmërinë e treguar nga vetë viktimja, për të përfunduar agresionin që tanimë e kishte nisur duke plasuar goditjen e parë me drapër. Duke qenë i bindur për superioritetin e tij fizik dhe aftësinë e tij për ta goditur A P para se A P ta godiste atë, viktimja nuk i ndaloi veprimet e tija edhe kur e pa se A P kishte nxjerrë armën nga shpatulla e tij, kishte larguar siguresën dhe mbushur armën, gati për të qëlluar. Vendosmëria e viktimës prandaj bëri që i akuzuari të frikësohej e çka justifikon heqjen e dënimit.

Në fund, gjykata e shkallës së parë ka bërë arsyetimin pse ka ardhur në përfundim se analiza e ADN-së për të caktuar se gjaku i kujt ishte në tehun e draprit ishte e panevojshme. Duke marrë parasysh sasinë e gjakut të derdhur në vendngjarje nga të dy individët e pranishëm, rreziku i kontaminimit të provave ishte thjesht shumë i lartë që ekzekutimi i analizës së ADN-së të kishte kuptim.

Përkitazi me motivin/motivet e të pandehurit për të cilat mbrojtja pretendon se nuk janë vërtetuar drejt, ky koleg vëren se motivi/motivet e krimit nuk është/janë pjesë e vetë krimit siç përcaktohet me ligj. Gjykata Supreme e Kosovës megjithatë pranon gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se grindja lidhur me kullotjen e bagëtisë në atë zonë i parapriu dhe në fund shkaktoi incidentin. Ky fakt është vërtetuar me dëshminë e dëshmitarit I I i cili konfirmoi se i akuzuari dhe dy persona të tjerë i kishin thënë atij të mos i kulloste bagëtisë në atë pjesë dhe t'ia thoshte këtë edhe P F. Megjithatë, për gjykatën nuk ekziston asnjë obligim ligjor për vërtetimin e motivit që e qoi të pandehurin deri te kryerja e veprës penale. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ky argument është jomeritor.

Sa i përket kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës ka një pikëpamje tjetër nga ajo e avokatit mbrojtës të të pandehurit. Vepra penale e Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve është veprë veçanërisht e rëndë e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet. Argumenti i avokatit mbrojtës se për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, gjykata zakonisht shqipton dënim me kusht është i pabazuar. Posaçërisht në raste penale, rrethanat asnjëherë nuk janë të njëjta në secilën lëndë dhe gjykatat duhet të ofrojnë arsye përkatëse dhe të mjaftueshme në secilën lëndë kur bëhet shqiptimi i dënimit duke marrë parasysh rrethanat individuale të të pandehurit. Duke marrë parasysh rrethanat specifike në lidhje me lëndën, mënyrën në të cilën është kryer krimi – *modus operandi* si dhe intensiteti i rrezikut shoqëror të veprës penale, kjo gjykatë vjen në përfundim se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, d.m.th. është në përputhje me qëllimin e dënimit, siç

përcaktohet me ligj. Prandaj Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkallës së parë ka ekzaminuar drejt dhe plotësisht të gjitha rrethanat përkatëse dhe ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm në shqiptimin e dënimit për llojin dhe kohëzgjatjen e tij.

VI. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsyet e përmendura më lart, në përputhje me nenin 420 (4) të KPPK-së Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS **Ap-Kz 89/11, 18 maj 2012**

Kryetar i kolegjit:

Francesco Florit
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës:

Adnan Isufi
Zyrtar ligjor

Anëtarët e kolegjit:

Martti Harsia,
Gjyqtar i EULEX-it

Nazmije Ibrahim
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme